



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3632/ 10 Prot.

Datë 26/01/2026

V E N D I M

Nr. 139/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26/01/2026 me:

Objekt: Pezullimin e procedurës së prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-61978-09-18-2025, me objekt: “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Demir Gashi”, Bashkia Dibër 2025”, me fond limit 118,385,642.50 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 17.10.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër.

Ankimues: Operatori ekonomik *LIQENI VII* SHPK me NIPT K01730502W dhe me adresë: *Rruga “Dituria”, Zona Kadastrale nr.8516 Nr.pasurie 10/268, Lagjja 14, Kodi Postar 2007, Shkozë, Durrës.*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Dibër
Adresa: Bulevadi “Elez Isufi” Peshkopi.

Baza Ligjore: Nenet 30, 115, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.09.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-61978-09-18-2025, me objekt: “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Demir Gashi”, Bashkia Dibër 2025”, me fond limit 118,385,642.50 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 17.10.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër.

II.2. Në datë 17.10.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) konstatohet se në datën 05.12.2025 është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

1	"NIKA SHPK	me vlerë oferte	76.967.028,28	leke	kualifikuar
---	------------	-----------------	---------------	------	-------------

2	"INA" SHPK	me vlerë oferte	86.896.059,00	leke	kualifikuar
3	"2 N" SHPK	me vlerë oferte	88.196.167,00	leke	kualifikuar
4	BOE "SELAMI SHPK & R/S/M CONSTRUCTION SHPK"	me vlerë oferte	89.172.525,39	leke	skualifikuar
5	"RAFIN COMPANY" SHPK	me vlerë oferte	92.103.340,41	leke	kualifikuar
6	"LIQENI VII" SHPK	me vlerë oferte	93.242.369,48	leke	kualifikuar
7	"DION-AL" SHPK	me vlerë oferte	94.191.151,15	leke	kualifikuar
8	BOE "LIS KONSTRUKSION SHPK & VIANTE Konstruksion SHPK"	me vlerë oferte	96.962.458,40	leke	skualifikuar
9	"ALKO-IMPEX General Construcion" SHPK	me vlerë oferte	100.627.113,22	leke	kualifikuar
10	BOE "AURORA KONSTRUKSION SHPK & DESARET COMPANY SHPK"	me vlerë oferte	106.422.917,10	leke	skualifikuar
11	"MF INVEST GROUP" SHPK	me vlerë oferte	117.207.043,10	leke	skualifikuar
12	"REJ" SHPK	me vlerë oferte	117.614.361,50	leke	skualifikuar
13	"EN-SAL" SHPK	me vlerë oferte	118.002.188,85	leke	skualifikuar

II.4. Në datën 18.12.2025, autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim – Fituesit Paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, ku për këtë procedurë prokurimi janë shpallur fitues paraprak oferta e operatorit ekonomik “NIKA” SHPK.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2025/6183, datë 18.12.2025 dhe me numër protokoll nr. 3632/2025 prot, datë 19.12.2025 e operatorit ekonomik “LIQENI VII” SHPK, duke kërkuar pezullimin e procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 3632/1 prot., datë 19.12.2025, janë publikuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues në lidhje me kërkesën e tij për pezullimin e procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.7. Me shkresën nr. 52 prot., datë 08.01.2026 me objekt “Kërkesë për plotësim dokumentacioni” protokolluar me tonën me numër nr. 3632/2 prot, datë 12.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me kërkesën e bërë nga autoriteti kontraktor drejtuar operatorit ekonomik ankimues “LIQENI VII” SHPK, përsa i përket

respektimit të përcaktimeve të nenit 111, pika 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si më poshtë vijon:

“... Në datën 18.12.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor Bashkia Dibër, është protokolluar ankesa me nr. 3632/2025, datë 19.12.2025 dhe numër elektronik A/2025/6183, datë 18.12.2025, e operatorit ekonomik "LIQENI VII" SHPK në procedurën e prokurimit "E hapur", me Nr. REF-61978-09-18-2025, me objekt: "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Demir Gashi", Bashkia Dibër 2025" me fond limit 118,385,642.50 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 17.10.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kërkesën e operatorit ekonomik "LIQENI VII" SHPK për pezullimin e procedurës së mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 111, pika 2 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar në të cilin citohet që:

“Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhe ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.”.

Nga kontrolli i bërë nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik rezulton që mungon dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e sipërcituar dhe në këtë rast bazuar në nenin 111, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar në të cilin citohet që:

“3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpermendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”.

Autoriteti kontraktor Bashkia Dibër kërkon nga ana juaj paraqitjen e mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik Brenda 2 ditëve nga marrja e këtij njoftimi për të vijuar me shqyrtimin e ankesës së sipërcituar nga ana jonë, në rast të kundërt kjo ankesë do të vlerësohet e paparaqitur.”.

II.8. Me shkresën nr. 185 prot., datë 15.01.2026 me objekt “Kërkesë për informacion” protokolluar me tonën me numër nr. 3632/3 prot, datë 19.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me kërkesën e bërë nga autoriteti kontraktor drejtuar operatorit ekonomik ankimues “LIQENI VII” SHPK, përsa i përket respektimit të përcaktimeve të nenit 111, pika 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si më poshtë vijon:

“... Në datën 18.12.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor Bashkia Dibër, është protokolluar ankesa me nr.

3632/2025, datë 19.12.2025 dhe numër elektronik A/2025/6183, datë 18.12.2025, e operatorit ekonomik "LIQENI VII" SHPK në procedurën e prokurimit "E hapur", me Nr. REF-61978-09-18-2025, me objekt: "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Demir Gashi", Bashkia Dibër 2025", me fond limit 118,385,642.50 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 17.10.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kërkesën e operatorit ekonomik "LIQENI VII" SHPK për pezullimin e procedurës së mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 111, pika 2 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar në të cilin citohet që:

"Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpermendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën."

Nga kontrolli i bërë nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik rezultoi që mungon dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e sipërcituar dhe në këtë rast bazuar në nenin 111, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar në të cilin citohet që:

"3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpermendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të behet me sdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur."

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik."

Autoriteti kontraktor Bashkia Dibër me shkresën numër. 52 prot, datë 08.01.2016 i është drejtuar operatorit ekonomik "LIQENI VII" Shpk në mënyrë elektronike me emailin zyrtar të deklaruar në QKB dhe nëpërmjet postës, shkresë e cila ka qënë dhe për diejini të institucionit tuaj për të paraqitur dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e bërë brenda 2 ditëve nga njoftim dhe deri më sot nuk kemi marrë asnjë llojë përgjigje.

Për sa më sipër kërkojmë nga ana juaj vënjen në dispozicion të dokumentit bankar që vërteton pagesën e tarifës nëse disponohet një e tillë për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës të operatorit në fjalë ose në rast të kundërt kjo ankesë nuk mund të merret në shqyrtim nga ana jonë bazuar nënenin 111, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe vlerësohet si e paparaqitur gjë e cila kërkon një konfirmim nga ana juaj për të vazhduar me hapat e tjera të procedurës së prokurimit."

II.9. Me memon nr. 3632/4 prot., datë 20.01.2026, i është kërkuar Sektorit të Financës (këtu) informacion, nëse operatori ekonomik ankimues "LIQENI VII" SHPK., ka paraqitur apo jo pranë KPP, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës për ankesën e paraqitur për procedurën objekt - ankimi.

II.10. Me shkresën nr. 3632/5 prot., datë 22.01.2026, Sektori i financës informon se: "Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 3632/4 prot., datë 20.01.2026, me lëndë: "Kërkesë për verifikim

pagesë”, ju bëjmë me dije se për ankesën me nr. 3632/2025 prot., datë 18.12.2025 me numër ankimi elektronik A/2025/6183, Operatori ekonomik “LIQENI VII” Shpk nuk ka paraqitur dokumentin bankar që të vërtetojë pagesën.

Në vijim të shkresës tuaj janë kryer verifikime me raportin e dërguar më datë 14.01.2026 për arkëtimet e kryera për muajin Dhjetor 2025, ku rezulton se Operatori ekonomik “LIQENI VII” SHPK nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar.”.

II.11. Me shkresën nr. 7 prot., datë 21.01.2026, protokolluar me tonën me numër nr. 3632/6 prot, datë 23.01.2026, operatori ekonomik ankimues “LIQENI VII” SHPK sqaron Komisionin e Prokurimit Publik, si më poshtë vijon:

“Në vijim të shkresës së Autoritetit Kontraktor Bashkia Dibër, me nr. 185 prot., datë 15/01/2026, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe duke marrë në konsideratë zhvillimet procedurale të mëparshme, shoqëria "LIQENI VII" sh.p.k. paraqet këtë sqarim zyrtar.

Procedura e prokurimit me nr. REF-61978-09-18-2025, me objekt "Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare 'Demir Gashi', Bashkia Dibër" është objekt i një procesi gjyqësor administrativ në zhvillim. Ky fakt procedural është i njohur dhe i dokumentuar, dhe Komisioni i Prokurimit Publik ka dijeni të plotë mbi këtë situatë, duke qënë palë pjesëmarrëse në seancat gjyqësore të mëparshme që lidhen me këtë çështje.

Në këto kushte, konsiderojmë se dijenia institucionale mbi ekzistencën e procesit gjyqësor është e padiskutueshme, dhe për rrjedhojë edhe Autoriteti Kontraktor duhet të konsiderohet i informuar mbi këtë rrethanë, në përputhje me parimet e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe sigurisë juridike.

Theksojmë se çështja në fjalë nuk lidhet me elementë formalë apo teknike procedurale, por me faktin thelbësor se vijimi i procedurës së prokurimit në kushtet e një procesi gjyqësor aktiv krijon një situatë juridike të pasigurt dhe ekspozon institucionet ndaj pasojave të rënda financiare dhe ligjore.

Në kushtet kur institucionet përgjegjëse kanë dijeni mbi këtë situatë, masa e arsyeshme, proporcionale dhe e domosdoshme ishte pezullimi i procedurës së prokurimit nr. REF-61978-09-18-2025, duke përfshirë pezullimin e çdo veprimi të mëtejshëm administrativ që çon drejt përfundimit të procedurës dhe lidhjes së kontratës, deri në shprehjen e gjykatës kompetente mbi çështjen në shqyrtim.

Pezullimi i procedurës nënkupton në mënyrë të qartë dhe të shprehur se, gjatë kësaj periudhe, nuk lejohet kryerja e asnjë veprimi administrativ me efekt juridik përfundimtar, përfshirë, por pa u kufizuar në:

- shpallien përfundimtare të fituesit ose konfirmimin e fituesit paraprak;*
- nënshkrimin apo lidhjen e kontratës së prokurimit;*
- vijimin ose përfundimin e afateve të ankimimit;*

- çdo veprim tjetër administrativ që krijon fakte të kryera ose e bën të pamundur apo tepër të vështirë ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të ardhshëm.

Kjo masë është e domosdoshme për të garantuar sigurinë juridike të procesit, për të shmangur krijimin e pasojave të pakthyeshme dhe për të parandaluar dëmin që mund t'i shkaktohet buxhetit të shtetit në rast të një vendimmarrjeje të mëvonshme gjyqësore që konstaton paligjshmëri.

Ky sqarim dhe kjo kërkesë paraqiten me qëllim që të formalizohet qartësisht dijenia institucionale mbi rrethanat faktike dhe juridike, dhe që në të ardhmen të mos mund të pretendohet mungesë dijenie mbi pasojat që mund të rrjedhin nga vijimi i procedurës në kushtet aktuale.

Shoqëria "LIQENI VII" sh.p.k. rezervon çdo të drejtë ligore për mbrojtjen e interesave të saj të ligjshme.

Bashkëlidhur kësaj shkrese, për dijeni dhe referencë, lutemi të gjeni shkresën e Autoritetit Kontraktor, Bashkia Dibër, e cila ka shërbyer si shkak për këtë komunikim dhe për sqarimet e mësipërm.”.

Bashkalidhur shkresa nr. 185 prot., datë 15.01.2026 me objekt “Kërkesë për informacion” e autoritetit kontraktor Bashkia Dibër.

II.12. Me shkresën nr. 3632/7 prot., datë 26.01.2026, Sektori i financës informon se: “Në vijim të shkresës me nr.3632/5 datë 22.01.2026, me lëndë “Kthim përgjigje”, ju bëjmë me dije se bazuar në raportin e dëguar nga Dega e Thesarit, për arkëtimet e periudhës 01.01.2026-16.01.2026 rezulton se Operatori ekonomik “LIQENI VII” shpk nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën me nr.3632/2025 prot., dhe numër ankimi elektronik A/2025/6183.”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton:

II.1. Lidhur me ankesën e administruar në datën 18.12.2025 nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave nga operatori ekonomik “LIQENI VII” SHPK, me numër ankimi elektronik nr. A/2025/6183 dhe me numër protokoli nr. 3632/2025 prot, datë 19.12.2025, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-61978-09-18-2025, me objekt: “Rikonstruktion i shkollës 9-vjeçare “Demir Gashi”, Bashkia Dibër 2025”, me fond limit 118,385,642.50 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 17.10.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër, mbi kërkesën e operatori

ekonomik “LIQENI VII” SHPK për pezullimin e procedurës së prokurimit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.
2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton

pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.1. Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është parashikuar se:

“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.

III.1.2. Me shkresën nr. 52 prot., datë 08.01.2026 me objekt “Kërkesë për plotësim dokumentacioni” protokolluar me tonën me numër nr. 3632/2 prot, datë 12.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me kërkesën e bërë nga autoriteti kontraktor drejtuar operatorit ekonomik ankimues “LIQENI VII” SHPK, përsa i përket respektimit të përcaktimeve të nenit 111, pika 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si më poshtë vijon:

“... Në datën 18.12.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor Bashkia Dibër, është protokolluar ankesa me nr. 3632/2025, datë 19.12.2025 dhe numër elektronik A/2025/6183, datë 18.12.2025, e operatorit ekonomik “LIQENI VII” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-61978-09-18-2025, me objekt: “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Demir Gashi”, Bashkia Dibër 2025” me fond limit 118,385,642.50 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 17.10.2025 nga autoriteti

kontraktor Bashkia Dibër. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kërkesën e operatorit ekonomik "LIQENI VII" SHPK për pezullimin e procedurës së mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 111, pika 2 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar në të cilin citohet që:

"Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhe ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën."

Nga kontrolli i bërë nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik rezultoi që mungon dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e sipërcituar dhe në këtë rast bazuar në nenin 111, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar në të cilin citohet që:

"3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur."

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik."

Autoriteti kontraktor Bashkia Dibër kërkon nga ana juaj paraqitjen e mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik Brenda 2 ditëve nga marrja e këtij njoftimi për të vijuar me shqyrtimin e ankesës së sipërcituar nga ana jonë, në rast të kundërt kjo ankesë do të vlerësohet e paparaqitur."

III.1.3. Me shkresën nr. 185 prot., datë 15.01.2026 me objekt "Kërkesë për informacion" protokolluar me tonën me numër nr. 3632/3 prot, datë 19.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me kërkesën e bërë nga autoriteti kontraktor drejtuar operatorit ekonomik ankimues "LIQENI VII" SHPK, përsa i përket respektimit të përcaktimeve të nenit 111, pika 2 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si më poshtë vijon:

"... Në datën 18.12.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor Bashkia Dibër, është protokolluar ankesa me nr. 3632/2025, datë 19.12.2025 dhe numër elektronik A/2025/6183, datë 18.12.2025, e operatorit ekonomik "LIQENI VII" SHPK në procedurën e prokurimit "E hapur", me Nr. REF-61978-09-18-2025, me objekt: "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Demir Gashi", Bashkia Dibër 2025", me fond limit 118,385,642.50 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 17.10.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kërkesën e operatorit ekonomik "LIQENI VII" SHPK për pezullimin e procedurës së mësipërme të prokurimit."

Bazuar në nenin 111, pika 2 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar në të cilin citohet që:

“Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpermendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhe ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.”.

Nga kontrolli i bërë nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik rezultoi që mungon dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e sipërcituar dhe në këtë rast bazuar në nenin 111, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar në të cilin citohet që:

“3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpermendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me sdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”.

Autoriteti kontraktor Bashkia Dibër me shkresën numër. 52 prot, datë 08.01.2016 i është drejtuar operatorit ekonomik “LIQENI VII” Shpk në mënyrë elektronike me emailin zyrtar të deklaruar në QKB dhe nëpërmjet postës, shkresë e cila ka qënë dhe për diejini të institucionit tuaj për të paraqitur dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e bërë brenda 2 ditëve nga njoftim dhe deri më sot nuk kemi marrë asnjë llojë përgjigje.

Për sa më sipër kërkojmë nga ana juaj vënjen në dispozicion të dokumentit bankar që vërteton pagesën e tarifës nëse disponohet një e tillë për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës të operatorit në fjalë ose në rast të kundërt kjo ankesë nuk mund të merret në shqyrtim nga ana jonë bazuar nënenin 111, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe vlerësohet si e paparaqitur gjë e cila kërkon një konfirmim nga ana juaj për të vazhduar me hapat e tjera të procedurës së prokurimit.”.

III.1.4. Me shkresën nr. 7 prot., datë 21.01.2026, protokolluar me tonën me numër nr. 3632/6 prot, datë 23.01.2026, operatori ekonomik ankimues “LIQENI VII” SHPK sqaron Komisionin e Prokurimit Publik, si më poshtë vijon:

“Në vijim të shkresës së Autoritetit Kontraktor Bashkia Dibër, me nr. 185 prot., datë 15/01/2026, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe duke marrë në konsideratë zhvillimet proceduriale të mëparshme, shoqëria "LIQENI VII" sh.p.k. paraqet këtë sqarim zyrtar.

Procedura e prokurimit me nr. REF-61978-09-18-2025, me objekt "Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare 'Demir Gashi', Bashkia Dibër" është objekt i një procesi gjyqësor administrativ në zhvillim. Ky fakt procedural është i njohur dhe i dokumentuar, dhe Komisioni i Prokurimit Publik ka dijeni të plotë mbi këtë situatë, duke qënë palë pjesëmarrëse në seancat gjyqësore të mëparshme që lidhen me këtë çështje.

Në këto kushte, konsiderojmë se dijenia institucionale mbi ekzistencën e procesit gjyqësor është e padiskutueshme, dhe për rrjedhojë edhe Autoriteti Kontraktor duhet të konsiderohet i

informuar mbi këtë rrethanë, në përputhje me parimet e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe sigurisë juridike.

Theksojmë se çështja në fjalë nuk lidhet me elementë formalë apo teknike proceduriale, por me faktin thelbësor se vijimi i procedurës së prokurimit në kushtet e një procesi gjyqësor aktiv krijon një situatë juridike të pasigurt dhe ekspozon institucionet ndaj pasojave të rënda financiare dhe ligjore.

Në kushtet kur institucionet përgjegjëse kanë dijeni mbi këtë situatë, masa e arsyeshme, proporcionale dhe e domosdoshme ishte pezullimi i procedurës së prokurimit nr. REF-61978-09-18-2025, duke përfshirë pezullimin e çdo veprimi të mëtejshëm administrativ që çon drejt përfundimit të procedurës dhe lidhjes së kontratës, deri në shprehjen e gjykatës kompetente mbi çështjen në shqyrtim.

Pezullimi i procedurës nënkupton në mënyrë të qartë dhe të shprehur se, gjatë kësaj periudhe, nuk lejohet kryerja e asnjë veprimi administrativ me efekt juridik përfundimtar, përfshirë, por pa u kufizuar në:

- shpallien përfundimtare të fituesit ose konfirmimin e fituesit paraprak;
- nënshkrimin apo lidhjen e kontratës së prokurimit;
- vijimin ose përfundimin e afateve të ankimimit;
- çdo veprim tjetër administrativ që krijon fakte të kryera ose e bën të pamundur apo tepër të vështirë ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të ardhshëm.

Kjo masë është e domosdoshme për të garantuar sigurinë juridike të procesit, për të shmangur krijimin e pasojave të pakthyeshme dhe për të parandaluar dëmin që mund t'i shkaktohet buxhetit të shtetit në rast të një vendimmarrjeje të mëvonshme gjyqësore që konstaton paligjshmëri.

Ky sqarim dhe kjo kërkesë paraqiten me qëllim që të formalizohet qartësisht dijenia institucionale mbi rrethanat faktike dhe juridike, dhe që në të ardhmen të mos mund të pretendohet mungesë dijenie mbi pasojat që mund të rrjedhin nga vijimi i procedurës në kushtet aktuale.

Shoqëria "LIQENI VII" sh.p.k. rezervon çdo të drejtë ligjore për mbrojtjen e interesave të saj të ligjshme.

Bashkëlidhur kësaj shkrese, për dijeni dhe referencë, lutemi të gjeni shkresën e Autoritetit Kontraktor, Bashkia Dibër, e cila ka shërbyer si shkak për këtë komunikim dhe për sqarimet e mësipërme.”.

Bashkalidhur shkresa nr. 185 prot., datë 15.01.2026 me objekt “Kërkesë për informacion” e autoritetit kontraktor Bashkia Dibër.

III.1.5. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, sikurse është formulari përkatës dhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimuesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cënon parimin e efijencës në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimuesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimuesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP përmes shkresës nr. 52 prot., datë 08.01.2026 me objekt “*Kërkesë për plotësim dokumentacioni*” protokolluar me tonën me numër nr. 3632/2 prot, datë 12.01.2026, si dhe shkresës nr. 185 prot., datë 15.01.2026 me objekt “*Kërkesë për informacion*” protokolluar me tonën me numër nr. 3632/3 prot, datë 19.01.2026 rezulton, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, duke respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, sepse përmes postës elektronike në adresën e postës elektronike t137 deklaruar nga ankimuesi në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përmes postës me rrugë shkresore i ka kërkuar operatorit ekonomik “*LIQENI VII*” SHPK, ndreqjen e të metave të ankesës, si në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi faktet dhe provat bashkëlidhur dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor thekson, se ky i fundit ka njoftuar (*më datë 08.01.2026*) operatorin ekonomik ankimues përmes postës elektronike dhe postës me rrugë shkresore, në lidhje me korrigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, konkretisht pagesës së tarifës së ankesës, ndërkohë që referuar informacionit dhe

dokumentacionit të dërguar nga autoritetit kontraktor me shkresën nr. 185 prot., datë 15.01.2026 me objekt “Kërkesë për informacion” protokolluar me tonën me numër nr. 3632/3 prot, datë 19.01.2026, si dhe shkresës nr. 7 prot., datë 21.01.2026, protokolluar me tonën me numër nr. 3632/6 prot, datë 23.01.2026 të operatori ekonomik ankimues “LIQENI VII” SHPK konstatohet se operatori ekonomik ankimues “LIQENI VII” SHPK nuk i është përgjigjur kësaj kërkesë të autoritetit kontraktor, duke mos rregulluar të metat e ankesës.

Gjithashtu me shkresën nr. 3632/5 prot., datë 22.01.2026, lidhur me kërkesën e bërë për statusin e ankesës së operatorit ekonomik “LIQENI VII” SHPK, Sekori i Financës pranë KPP, informon se: “Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 3632/4 prot., datë 20.01.2026, me lëndë: “Kërkesë për verifikim pagese”, ju bëjmë me dije se për ankesën me nr. 3632/2025 prot., datë 18.12.2025 me numër ankimi elektronik A/2025/6183, Operatori ekonomik “LIQENI VII” Shpk nuk ka paraqitur dokumentin bankar që të vërtetojë pagesën.

Në vijim të shkresës tuaj janë kryer verifikime me raportin e dërguar më datë 14.01.2026 për arkëtimet e kryera për muajin Dhjetor 2025, ku rezulton se Operatori ekonomik “LIQENI VII” SHPK nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar.”, ndërkohë që me shkresën nr. 3632/7 prot., datë 26.01.2026, lidhur me kërkesën e bërë për statusin e ankesës së operatorit ekonomik “LIQENI VII” SHPK, Sekori i Financës pranë KPP, informon se: “Në vijim të shkresës me nr.3632/5 datë 22.01.2026, me lëndë “Kthim përgjigje”, ju bëjmë me dije se bazuar në raportin e dërguar nga Dega e Thesarit, për arkëtimet e periudhës 01.01.2026-16.01.2026 rezulton se Operatori ekonomik “LIQENI VII” shpk nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën me nr.3632/2025 prot., dhe numër ankimi elektronik A/2025/6183.”.

Sa më sipër, konstatohet se ankimuesi nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës në përputhje me përcaktimet e pikës 2 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar duke mos plotësuar kështu një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës.

Sa më sipër argumentuar, për sa kohë, kërkesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë Komisionit Prokurimit Publik nuk plotëson kushtet formale, siç është pagesa e tarifës rrjedhimisht kjo ankesë duhet refuzuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*LIQENI VII*” SHPK për procedurën e prokurimit “*E hapur*”, me Nr. *REF-61978-09-18-2025*, me objekt: “*Rikonstruktion i shkollës 9-vjeçare “Demir Gashi”, Bashkia Dibër 2025*”, me fond limit 118,385,642.50 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 17.10.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

